

Studentët-sportistë në Universiadën e 25-të të Beogradit



Në datat 1-12 Korrik u zhvillua në Beograd (Serbi), veprimtaria më e rëndësishme e sportit universitar botëror, e dyta për nga rëndësia pas Lojërave Olimpikë, Universiada e 25-të Botërore e Sportit Studentor. Në të morrën pjesë rreth 10000 studentë - sportistë që përfaqësuan 144 shtete dhe që konkuruan ndërmjet tyre në 14 disiplina sportive.


Në përfundim të kësaj veprimtarie medaljet e arta i merituan studentët - sportistë kinezë të ndjekur nga ata japonezë e koreanë.

Në këtë veprimtari tejet të rëndësishme për lëvizjen sportive studentore mbarëbotërore morri pjesë dhe një delegacion sportiv nga Shqipëria, që për herë të parë u mbështet nga Akademia e Edukimit Fizik dhe



Sporteve nën kujdesin e veçantë të Rektorit të saj z. Vesel Rizvanolli.

Sportistët, studentë në Akademinë e Sportit, përfaqësuan vendin në



disiplinën sportive të atletikës dhe gjimnastikës artistike dhe përkatësisht: në kërcimin tre hapësh nga sportistja Marsida Dardha; në garën e 100m nga atletja Arta Sadrija dhe në 400m nga atleti Dritan Musta; ndërsa në gjimnastikën artistike, vendin e përfaqësoi gjimnasti yne Florian Toska. Studentët – sportistë bënë një paraqitje dinjitoze dhe dhanë më të mirën e tyre që përkon me nivelin e rezultateve të arritura në vend.

Një sërë veprimtarish të tjera të rëndësishme i paraprinë zhvillimit të garave. Në datat 28-29 Qershor zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e FISU-s në të cilën u bë një pasqyrë e arritjeve dhe u morrën një sërë vendimesh të rëndësishme për ecurinë e mëtejshme të sportit universitar botëror. Po kështu, në të u paraqitën dhe përgatitjet që po bëhen për veprimtari të tjera të ngjashme siç ishte dhe Universiada e vitit 2011 që do të zhvillohet në Shenzhen (Kinë), përfaqësuesit më të lartë të së cilës kanë pasur tashmë një vizitë të suksesshme, të planifikuar prej mëse një viti, në Shqipëri dhe kanë premtuar për një bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen në lidhje me sportin dhe edukimin.

Një moment tjetër i rëndësishëm ka qenë dhe Konferenca e FISU-t që u mbajt në datat 2-5 Korrik nën moton “Roli i Sportit Universitar në edukim dhe në shoqëri – një platformë për ndryshim”. Në të u paraqitën një sërë punimesh në lidhje me marrëdhëniet që sporti krijon me vlerat etike, sjelljet, kulturën, shëndetin dhe inteligjencën. Midis tyre u prezantua dhe një punim shkencor i përgatitur nga Prof. Asc. Dr Fatos Gjata me temë: “Aspekte sociologjike të sportit universitar në Shqipëri”.

Takime të shumta me krerët më të lartë të FISU-s siç ishte ai me presidentin e saj z.Xhorxh Killian, Sekretarin e Përgjithshëm z.Erik Straindord dhe kryetarët e delegacioneve të shteteve si Itali, Greqi, Rumani, Zvicër, Turqi etj, shoqëruan qëndrimin tonë në Beograd. Në këto takime, ne morrëm mbështetjen dhe përkrahjen e tyre për të qenë prezent në rrugën e zhvillimit të sportit universitar në Shqipëri, të cilën e tregon dhe planifikimi së shpejti i vizitës së krerëve më të lartë të FISU-s në vendin tonë.



Kjo veprimtari tejet e suksesshme si dhe arritjet e deritanishme (pjesëmarrës në 5 Universiada Botërore të zhvilluara brenda këtij dhjetëvjeçari ku sporti universitar shqiptar është tashmë anëtar me të drejta të

plota në FISU-s dhe në EUSA-s që nga viti 2005), kanë krijuar një mendësi të re për organizimin dhe menaxhimin e lëvizjes sportive studentore në shkallë vendi në përputhje me ecurinë e mbarë lëvizjes sportive studentore ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, do të mund të realizohet detyrimi që kemi ndaj masës së madhe të rinjve për të gjallëruar jetën sportive studentore duke ndikuar në edukimin e tyre përmes sportit dhe në të njëjtën kohë duke i shërbyer atyre nëpërmjet ngritjes së Qendrave Sportive Studentore pranë Universiteteve të vendit. Gërshetimi i punës përmes institucioneve shtetërore (MASH, MTKRS), Akademisë së Sporteve, shoqatave që kanë lidhje me aspektet rinore, afrimit të shoqërive të biznesit dhe të të gjithë faktorëve të interesit do të ishte një hap tjetër efikas në këtë drejtim.

Fatos Gjata

Përgjegjës i Delegacionit